

# RRETH UNIVERSITETIT

Universiteti "Ukshin Hoti" ka nisur punën më 2010, dhe ka gjashtë njësi akademike dhe ofron studime në ciklin Baçelor dhe Master në 20 programe studimore. Përveç studimeve në gjuhën mësimore shqipe Universiteti ofron studime edhe në gjuhën mësimore turke dhe boshnjake.

Universiteti trashëgon përvojën e ish Shkollës së Lartë Pedagogjike, që ka funksionuar nga viti 1961, dhe funksionon në kryeqytetin historik të Kosovës.



## KËSHILLTARËT AKADEMIK

**Personeli akademik, i angazhuar të shërbejnë si këshillues akademik për studentë në njësitë akademike:**

**Fakulteti i Edukimit**  
**Prof. Ass. Dr. Artan Reshani**  
artan.reshani@uni-prizren.com

NA KONTAKTONI



## KËSHILLIMI AKADEMIK

Suksesi Juaj, Prioriteti Ynë!



www.uni-prizren.com  
@universityofprizren



## MISIONI & VIZIONI

Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, është institucion akademik e konkurrues i orientuar në ofrimin e edukimit cilësor duke zhvilluar kërkime shkencore dhe duke kontribuar në inovacion, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe komunitetit ku vepron në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

Universiteti ndërton vizionin duke u mbështetur në parimin e vlerave edukativo-kërkimore, përparësive krahasuese të diversitetit etnik, gjuhësor dhe kulturor, me qëllim të krijimit të një qendre të ekselencës akademike e cila do t'i shërbejë studentëve, hulumtuesve dhe shoqërisë në fushat e TI, agrobiznesit dhe mjedisit, menaxhmentit dhe administrimit të biznesit, drejtësisë, gjuhësisë dhe edukimit.

## PUNA JONË FOKUSOHET NË:



Ndihmë studentëve në planifikimin akademik dhe të karrierës



Orientim për përmirësim e performancën në lëndët sfiduese



Orientim për punën praktike dhe punësim



Përgjigje në pyetje të ndryshme të studentëve për ndihmë dhe këshillim për aspekte tjera: psikologjike, juridike, etj..



**Këtu janë gjashtë pyetje të rëndësishme për t'i bërë këshilltarit tuaj akademik në Universitet:**

- **Cilat janë kërkesat specifike për Programin tim studimor dhe si mund të siguroj që jam në rrugën e duhur për të diplomuar në kohë?**
- **A ka ndonjë lëndë zgjedhore që rekomandoni të marr për programin tim studimor?**
- **A mund të më siguroni informacion mbi mundësitë e karrierës në lidhje me programin tim, dhe a ka mundësi të praktikës në dispozicion?**
- **A ka shërbime tutorimi ose burime mbështetëse akademike në kampus, dhe si mund të përmirësoj performancën time në lëndët sfiduese?**
- **Çfarë hapa duhet të ndjek kur më afrohet momenti i diplomimit, dhe a ka burime për kërkime pune apo plane pas diplomimit?**
- **A ka programe ose mundësi mobiliteti për studentët në programin tim studimor, dhe si mund të angazhohem në aktivitete jashtëkurrikulare që përputhen me synimet e mia?**

**Këto pyetje mbulojnë një gamë të gjerë të aspekteve të rëndësishme, duke përfshirë progresin akademik dhe planifikimin e karrierës deri te kërkimi i mbështetjes së shtesë dhe përdorimi i mundësive unike në fushën tënde të studimit.**

